

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 61560125
Nr. i fq. / Br. st -5-
Data 04.12.25
- VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
FONDIT I KOSOVËS PËR EFICIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSNI FUND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND
ARKIVI - ARHIVA - ARCHIVE

Nr.Br.No. 2109/25
Nr. i fq./Br.Str./No.pg. -5-
Data/Datum/Date: 01.12.25
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA



Republika e Kosovës
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë

02 Nr. PB 1091/25

Data: 04.12.2025

MARRËVESHJE

në mes të

Ministrisë së Ekonomisë

Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë

dhe

Komunës së Vushtrrisë

Për kalimin e pronësisë së pasurisë (aseteve) të investuara përmes Projektit
"Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë në objektet në pronësi të Komunës"

Prishtinë, 2025

Ministria e Ekonomisë, me adresë Sheshi "Zahir Pajaziti", nr. 36 10000 Prishtinë, (në vijim "Ministria"), e përfaqësuar nga Sekretarja e Përgjithshme znj. Leonita Shabani Mullarama,

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, me adresë rruga Migjeni Nr.21 ndërtesa ish-Banka e Lublanës, (në tekstin e mëtejshëm FKKE) përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues z. Driton Hetemi, dhe

Komuna e Vushtrrisë, me adresë Sheshi "Ahmet Knasniqi", nr.10 Vushtri, Kosovë (në vijim Komuna) e përfaqësuar nga Kryetari i Komunes z. Ferit Idrizi,

Duke u bazuar, në kompetencat e përcaktuara në Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenin 13 të Rregullores MF – Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenin 13 të Rregullores për Menaxhimin e Pasurive Jofinanciare të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Në zbatim të nenin 3 (g) të Marrëveshjes ndihmëse (Subsidiary Agreement) të datës 03.07.2020, ndërmjet (ish) Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, dhe Marrëveshjes për Shërbime të Energjisë (MSIE) në mes të FKKE dhe Komunës së Vushtrrisë,

Duke vlerësuar se, Palët dëshirojnë të formalizojnë kalimin e pronës (aseteve) dhe detyrimet përkatëse sipas dispozitave të përcaktuara me këtë Marrëveshje,

Pajtohen si në vijim:

Neni 1 **Objekti i Marrëveshjes**

1. Objekt i kësaj marrëveshje, bazuar në Marrëveshjen ndihmëse (Subsidiary Agreement) të datës 03.07.2020, ndërmjet (ish) Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, neni 3 (g), është bartja e pronësisë së asetëve të investuara përmes projekteve kapitale "Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë".

2. Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKKE), në kuadër të projekteve për zbatimin e masave të eficiencës së energjisë, ka zbatuar masat efiçiente të energjisë në ndërtesa publike në Komunën e Vushtrrisë. Për këtë qëllim është lidhur Marrëveshja për Shërbime të Energjisë (MSHE) me Komunën e Vushtrrisë, për objektin si vijon:

1. SH.F.M.U "Enver Maloku"

- Vlera e financimit: 198,629.26, me afat kthimi të investimit për 13 vite.
(Marrëveshja për Shërbime të Energjisë nënshkruar më 25.02.2022)

3.FKEE ka financuar projektin nga 3 burime financiare¹:

3.1.IDA Credit 5508-XK - që përfshin 35% të vlerës totale të faturave të punës të paguar përmes Ministrisë së Ekonomisë;

3.2. TF0B1487 - 54 % të vlerës totale të faturave të punës dhe 100% të vlerës totale të faturave audit, dizajn, mbikëqyrje dhe periudhë e defekteve, të paguara nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë;

3.3. GOK - Part - 11% nga Qeveria e Kosovës të vlerës totale të faturave të punës të paguara nga FKEE.

Neni 2 **Përgjegjësitë e palëve**

1. FKEE, në bazë të fondeve të alokuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për investime kapitale ka zbatuar masat e eficiencës së energjisë në objektet publike të Komunës së Vushtrisë në përputhje me marrëveshjen për shërbime të energjisë auditimet e energjisë, dizajnin dhe specifikacionet teknike të miratuara.²

2. Sipas Marrëveshjes ndihmese "Subsidiary Agreement", pas përfundimit të projekteve, FKEE bartë pronësinë e aseteve të investuara tek komuna në pajtim me procedurat për pasuritë kapitale dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Komuna e Vushtrisë pranon pronësinë mbi asetet e investuara dhe bartë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga këto asete përfshirë mirëmbajtjen dhe përdorimin e tyre për qëllime publike.

4. Pas nëshkrimit të kësaj Marrëveshje, Komuna obligohet të regjistrojë ato në regjistrat përkatës të pasurive kapitale sipas rregullave të përcaktuara nga Ministria përkatëse për Financa, dhe Thesari i Kosovës.

5. FKEE dhe Ministria e Ekonomisë mbajnë të drejtën e shfrytëzimit të të dhënave, monitorimit, dhe raportimit për performancën e aseteve, në përputhje me kërkesat e donatorëve dhe marrëveshjen në fuqi për MSHE në mes të FKEE dhe Komunës së Vushtrisë.

Neni 3 **Obligimet e Komunës**

1. Komuna e Vushtrisë merr në pronësi dhe menaxhim të plotë asetet e investuara përmes projektit për zbatimin e masave për eficiencë të energjisë, në pajtim me objektin e kësaj Marrëveshje dhe pa asnjë kufizim në përdorim për qëllime publike.

¹ Doracak Operational për FKEE nën projektin për Eficiencë të Energjisë dhe Energji të Rinovueshme i Përkrahur nga Banka Botërore/BE

² Marrëveshja për Shërbime të Energjisë

2. Komuna është përgjegjëse për mirëmbajtjen, përdorimin dhe funksionimin e rregullt të aseteve të pranuar si dhe për mbulimin e të gjitha obligimeve që rrjedhin nga posedimi i tyre, duke përfshirë edhe investimet në kuadër të projekteve.

3. Bashkë me asetet fizike, Komuna pranon në pronësi të gjithë dokumentacionin në formë digjitale (në CD) përfshirë:

3.1. Kontratat dhe faturat përkatëse;

3.2. Raportin e auditimit të energjisë në ndërtesa;

3.3. Projektin teknik detal dhe të zbatuar;

3.4. Urdhër blerjet (për pagesat në vlerë 35% të faturave) dhe urdhër pagesat;

3.5. Certifikatat e pranimit teknik dhe raportin përfundimtar i cili është pjesë e pagesave të fundit që e bën investimin si të kompletuar dhe të përfunduar.

4. Në momentin e dorëzimit të aseteve të investuara, FKKE dhe Ministria e Ekonomisë lirohen nga çdo detyrim që nderlidhet me funksionimin apo mirëmbajtjen e aseteve të dorëzuara.

5. Kjo marrëveshje ka të bëjë ekskluzivisht me kalimin e aseteve të investuara tek Komuna e cila obligohet të vazhdojë me regjistrimin, menagjimin dhe raportimin financiar dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve financiare ndaj FKKE-së, të përcaktuara me Marrëveshjen e Shërbimeve të Energjisë.

Neni 4

Gjendja teknike e projektit

1. FKKE i dorëzon Komunës asetet e projektit nga neni 1 pika 2 të kësaj Marrëveshjeje, në gjendje të rregullt teknike dhe sipas standardeve të paraqitura në projektin detal dhe specifikacionin teknik.

2. Asetet e dorëzuara duhet të jenë të vërtetuara nga kompanitë mbikëqyrëse të kontraktuara nga FKKE.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


1. Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje zgjidhet përmes bashkëpunimit të ndërsjellë dhe në frymën e marrëdhënieve të mira ndërmjet Palëve.

2. Në rast se mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim dhe bashkëpunim të ndërsjellë ndërmjet Palëve ajo, do t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Gjykata kompetente në Republikën e Kosovës.

Neni 6
Hyrja në fuqi

1. Marrëveshja hyn në fuqi dhe fillon së zbatuari nga dita e nënshkrimit të saj
2. Marrëveshja është përpiluar në tri (3) kopje identike në gjuhën shqipe, nga një (1) kopje për secilën palë.

MINISTRIA E EKONOMISË:


Leonita Shabani Mullarama
Sekretare e Përgjithshme



Datë: 01/12/25

FKEE:


Driton Hetemi
Drejtor Menaxhues



Datë: 01/12/25

KOMUNA E VUSHTRRIË:


Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës



Datë: 04/12/2025